



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:125853  
Datë: 25.06.2024  
Numri i dokumentit: 05858451

Ac.nr.7045/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Fatmir Baloku e Liridon Maloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. P nga Istogu, të cilën e përfaqëson F. K avokat në Pejë, kundër të paditurës Komuna e Istogut – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e diferencës në pagë në bazë të kualifikimit-licencimit, duke vendosur sipas ankesës të palës paditëse, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.390/2021 të datës 27.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e paditëses A. P nga Istogu, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.390/2021 i datës 27.09.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit refuzohet në tersi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses A. P nga Istogu, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguajë paditëses, në emër të kompensimit 27% të pagës mbi bazë të kualifikimit-licencimit për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 e deri më 31.12.2020 apo për 44 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumë nga 56.66 €), shumë e përgjithshme prej 2,493.18€, me kamat ligjore prej 8 % nga data 15.06.2021 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditorë nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II., të dispozitivit refuzohet në tersi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses A. P nga Istogu, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, në emër të shpenzimeve

të procedurës kontestimore, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 124 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë paditësja, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të refuzohet aktgjykimi i atakuar duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja A. P ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Istogut-Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit 27% të pagës mbi bazë të kualifikimit-licencimit për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 e deri më 31.12.2020 apo për 44 muaj pune (për secilën muaj të pranisë në punë shumën nga 56.66 €), shumën e përgjithshme prej 2,493.18€, me kamat ligjore prej 8 % nga data 15.06.2021 e deri në pagesën definitive të detyrimi.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se: themelësia e kërkesëpadiisë për paditësen nuk del nga faktet e treguara në padi, pasi që nga provat e ofruara nga pala paditëse vërtetohet fakti se me rastin e ushtrimit të padisë nuk ka qenë e pajisur me licencë.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë.

#### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar

faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë ka gjetur se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale. Nga shkresat e lëndës rrjedhë që paditësja nuk ka argumentuar se ka qenë e licencuar në kohën dhe për periudhën për të cilën e ka ushtruar padinë dhe rrjedhimisht nuk mund të thuhet se konsiderohet se ka licencë kur nuk e posedon një dokument të tillë e aq më tepër të kompensohet si e licencuar ndërsa e njëjta nuk e posedon licencën e nevojshme. Kolegji gjen se, është standard i kërimit dhe arritjes së drejtësisë se, një e drejtë palës jo vetëm se duhet që ti takojë, por ajo duhet edhe të kërkohe në mënyrën e përcaktuar me ligj. Për këto arsye, kolegji këto pretendime ankimore i ka refuzuar si të pa bazuara.

Në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret paditësja përveç kontestimit verbal, nuk kanë ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur. Në nenin 319.1 të LPK-së, gjithashtu është vendosur që secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kolegji i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar se, paditësit nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe këto pretendime të parashtruara në ankesën të njëjtës janë refuzuar si të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar. Nga sa u theksua si më lartë, kolegji pretendimet e paditëses të thëna në ankesë i ka refuzuar si të pa bazuara, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7045/2022 me datë 25.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj